



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo			CAA
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës			
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova			
Civil Aviation Authority of Kosovo			
Nr. i prot.	2025/ZDP/34		
Er. prot./Vend. Nr.			
Faqe:	2	Kopje:	28/01/2025
Stranica/Pages:		Kopije/Copy:	Date/Date
Hyrës/ulazno/in	<input type="checkbox"/>		
Daletë/sizlazo/out	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brandshëm/nterno/inletal	<input type="checkbox"/>		
			Prishtinë/Prština/Pristina

02/ZDP/VE/2025
Datë: 28 janar 2025

Në mbështetje të nenit 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe në pajtim me Rregulloren nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë, siç është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë (me tutje Rregullorja),

Duke vepruar në bazë të kërkesë të subjektit “Ex Fis” sh.p.k. për zgjatje të aprovimit si furnizues për palë të treta i shërbimeve në tokë për kategorinë 7.1 të shtojcës së Rregullore nr. 04/2011, me ndryshime,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

- VAZHDOHET** deri më 31 dhjetor 2025 aprovimi i subjektit “Ex Fis” sh.p.k. NRB 70272163, si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” për furnizim të aeroplanëve me derivate.
- OBLIGOHET** subjekti nga pika 1 e këtij Vendimi që gjatë kohës së ofrimit të shërbimeve t’iu përmbahet me përpikëri dispozitave të Rregullore nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 dhe akteve tjera normative në fuqi.
- Vendimi hyn në fuqi më 01 shkurt 2025.

Arsyetim

Subjekti “Ex Fis” sh.p.k. ka dorëzuar në AAC me dt. 15 nëntor 2018 aplikacionin përmes së cilit ka kërkuar vazhdimin e aprovimit të tij si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” specifikisht për furnizimin e aeroplanëve me derivate (kategoria 7.1 e shtojcës së Rregullore nr. 04/2011).

Nga data e aplikimit deri më tani janë lëshuar për operatorin “ExFis” shpk, aprovimet për zgjatje të përkohshme, si vijon: Vendimi nr. 01/ZDP/VE/2019 dt. 08.01.2019, Vendimi nr. 03/ZDP/VE/2019 dt. 14.02.2019, Vendimi nr. 03/ZDP/VE/2019 dt. 14.02.2019, Vendimi 25/ZDP/VE/2019 dt. 14.08.2019, Vendimi 27/ZDP/VE/2019 dt. 30.09.2019, Vendimin 31/ZDP/VE/2019 dt. 27.12.2019, Vendimi 01/ZDP/VE/2020 dt. 30.01.2020, Vendimi 03/ZDP/VE/2020 dt. 30.03.2020, Vendimi nr. 07/ZDP/VE/2020 dt. 29.07.2020, Vendimi me nr. 02/ZDP/VE/2022, dt. 27 janar 2022, 01/ZDP/VE/2023 dt. 31.01.2023 dhe 01/ZDP/VE/2024 dt. 30.01.2024. Vendimet e lartpërmendura për zgjatje të përkohshme të aprovimit për operatorin “Ex Fis” shpk janë lëshuar me qëllim që organi menaxhues i aeroportit të krijoj kushtet për hapje të tregut në përputhje me kërkesat rregullatore.

Më datën 19 janar, respektivisht 21 janar 2025, Drejtori i Përgjithshëm ka pranuar konfirmime nga njësitë përkatëse brenda AAC-së, përgjegjëse për mbikëqyrjen e sigurisë dhe të performancës ekonomike të ofruesve të shërbimeve në tokë. Sipas këtyre konfirmimeve, operatori në fjalë është subjekt i mbikëqyrjes së rregullt, në përputhje me planin vjetor të mbikëqyrjes së sigurisë dhe mbikëqyrjes ekonomike. Bazuar në konfirmimet e pranuar, është vlerësuar se operatori operon në përputhje me kërkesat rregullatore të standardeve të sigurisë, si ofrues i shërbimeve tokësore për furnizimin e mjeteve ajrore me derivate. Gjithashtu, është konfirmuar se operatori ka ruajtur vazhdimisht kriteret ekonomike mbi të cilat është aprovuar.

AAC, pas arritjes së pragut prej dy milion pasagjerëve në vit, deri më tani, ka lëshuar vetëm aprovime të përkohshme për ofruesit e shërbimeve tokësore për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", për shkak të mos krijimit të kushteve për hapjen e tregut. AAC do të vazhdojë monitorimin e vazhdueshëm të përmbushjes së kërkesave rregullatore të sigurisë dhe atyre ekonomike përmes procesit të auditimit.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, me ndryshime, si dhe nenin 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, lidhur me Rregulloren nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, siç është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019, vendimeve paraprake për vazhdim të përkohshëm të aprovimeve si dhe rekomandimeve të pranuar nga njësitë përkatëse në AAC, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit kontest administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.



Iu dërgohet:

- Ex Fis Sh.p.k. Blvd. Bill Kllinton AB7, 1000, Prishtinë;
- Organit menaxhues të ANP "Adem Jashari" LKIA, Vrellë, Komuna e Lipjanit;
- Ministrinë të MMPHI;
- Komitetin për Partneritet Publiko Privat;
- Arkivit të AAC-së.